

**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“DECANI LEATHER WORKS ” SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “**DECANI LEATHER WORKS** ” Sh.p.k.

1- Adriatik Deçani, atesia **Sabajdin** shtetase KOSOVAR, lindur me 05.05.2000 ne PEJE , identifikohet nepermjet pasaportes Nr.P01038501;

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themeli të shoqërisë “**DECANI LEATHER WORKS** ” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise eshte “**DECANI LEATHER WORKS** ” Sh.p.k.,

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionoje në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

**NENI3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: **Rruga “Demokracia”, Lagja nr.6 Kamez Tirane ,Objekti nr.4862 ,Kati 2 ,Shqiperi**

Në adresën e mesperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4

AKT THEMELIMI “DECANI LEATHER WORKS” SHPK



KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “**DECANI LEATHER WORKS**” Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie të konsulences dhe sherbimeve ndaj shoqerive ne Republiken e Shqiperise dhe ne territoret e tjera dhe ka si objekt të veprimitarise së saj:

5.1 Hapje rrobaqepsie, prodhim veshje te ndryshme, sherbime ne fushën e rrobaqepësisë me linjea fason vendase dhe të huaja. Tregtim i tekstileve, metrazheve dhe konfeksioneve me shumicë dhe pakicë, import dhe eksportimi i tyre.

Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteteve te ndryshme. Pjesëmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojne përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind mijë Leke), i ndare në 1 pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1- Adriatik Deçani **100,00 %**

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne një llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7 AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8 ORGANET DREJTUESE

AKT THEMELIMI “DECANI LEATHER WORKS**” SHPK**

Organet drejtuese të shoqërise do të janë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "**DECANI LEATHER WORKS**" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijoje edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator të shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emeruar **Arjol Lleshi**.

NENI 9 DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane 01.09.2021

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
"DECANI LEATHER WORKS" SH.P.K.**

Adriatik Deçani

